

Ndikimi i nacionalizmit në vendet në tranzicion: Qëndrimet ndaj nacionalizmit në kulturën politike

Venera Llunji*

Pëmbledhje

Nacionalizmi paraqet një sfidë serioze për vendet në tranzicion. Ai është një faktor i cili në mënyrë të jashtëzakonshme ndikon dhe ndërton procesin kalimtar në politikë në të gjitha vendet e Evropës Jug-Lindore. Nacionalizmi paraqet një sfidë për vendet ish-komuniste, veçanërisht për vendet siç janë ish-republikat e Jugosllavisë, meqë, siç thotë edhe Robert Kaplan në veprën e tij *"Balkan Ghosts: A Journey Through History, ... në Ballkan, asnjë luftë nuk është 'lokale'*.¹ Shoqëritë në Evropë po përjetojnë ndryshime të mëdha, posaçërisht në politikë dhe ekonomi, përmes fuqizimit të sistemeve të tyre demokratike, politike dhe ekonomike. Megjithatë, nacionalizmi dhe qëndrimet nacionaliste janë të pranishme në kulturën politike në vendet në tranzicion përkundër përpjekjeve për implementimin e demokracisë, ndryshimeve të shpejta dhe modernizimit të shoqërive në nivel institucional dhe në struktura shoqërore, si edhe përkundër ambientit të sapo krijuar të këtyre shoqërive. Vendet në tranzicion huazuan të ashtuquajturin veprim "copy-paste" dhe u përpoqën të implementojnë sisteme të tilla pa marrë parasysh specifikat e vendeve të tyre në tranzicion, por të cilat më pas u ballafaquan me dallimet, papërshtatshmërinë dhe shpesh edhe me pamundësinë e implementimit të tyre. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është përqendrimi në kulturën politike të vendeve në tranzicion, duke mbuluar nacionalizmin dhe procesin e demokratizimit si pjesë të rëndësishme të sistemit dhe kulturës politike.

Fjalët kyç: nacionalizmi, shoqëria, sistemi politik, kultura, demokracia

* Venera Llunji, PhD Cand. Universiteti AAB, Prishtinë, e-mail: venera.llunji@aab-edu.net

¹ Robert Kaplan. *Balkan Ghosts: A Journey Through History*. St. Martin's Press, New York, 1993

Hyrja

Kur shikojmë kompleksitetin dhe llojlojshmërinë e vendeve të Ballkanit, kuptojmë se çfarëdo identifikimi që mund t'i bëjmë emërtimit të të qenit ballkanas është pothuajse gjithherë jo i plotë, bile edhe kundërthënës. Në këtë rajon jetojnë popuj të ndryshëm; të ndryshëm nga prejardhja e tyre etnike, fetare, ekonomike, arsimore, politike; të ndryshëm në historinë e tyre të krijimit dhe zhvillimit, të ndryshëm në interesat e tyre, e çështje të shumta të tjera, me një fjalë, popuj me dallime të dukshme.

Një bashkëveprim i ndërlikuar i forcave të ndryshme historike, institucionale, ekonomike, gjeografike dhe atyre sociale vazhdimisht ri- definojnë edhe vetë mënyrën e të menduarit të njerëzve të cilët jetojnë në këtë hapësirë. Të kuptuarit e çfarëdo politike të këtyre vendeve do të jetë jo e plotë pa një përpjekje të vazhdueshme në të kontrolluarit e bashkëveprimit të këtyre forcave të cilat i formësojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre dhe të pjesëtarëve të këtyre vendeve.

Në këtë epokë moderne, fillesa të ndryshme të kulturës politike të vendeve të Ballkanit, veçanërisht të vendeve në tranzicion mund të ndahen në kategori si: liberalizimi ekonomik me përpjekjet për zhvillimin e tregut të lirë, i kombinuar me një konservatorizëm social, i cili mbështet dhe përkrah vlerat tradicionale dhe vlerat morale të secilës shoqëri, i veshur me petkun e populizmit i cili promovon të drejtat dhe vlerat e njerëzve të zakonshëm.

Këto tendenca kanë gjetur vend në një kulturë politike dominuese që tenton të favorizojë taksat dhe tatimet e ulëta, shërbime të favorshme të qeverisë dhe politikat për zhvillim të bizneseve, sidomos atyre të vogla e të mesme, e që në një ambient ballkanas nuk mund të realizohet me lehtësi siç do të planifikohej dhe realizohej në vendet e zhvilluara evropiane, aq më tepër kur « rrjedha e formësimit të identiteteve politike e kulturore të popujve të Ballkanit është e cilësuar me konflikte të ndërsjella në projektin e tyre që të sajojnë shtete »² Për

² Muhamedin Kullashi. *Përplasja e identiteteve*. Prishtinë: Dukagjini, 2003

më tepër, në vendet evropiane pjesë e kulturës politike janë edhe besimi në diplomaci dhe zgjidhje multilaterale të problemeve të përbashkëta, diskursi, retorika dhe argumentimi racional politik, besimi në pragmatizëm, në përgjegjësi dhe në vënien e të mirës së përbashkët mbi interesat nacionale dhe përfitimet individuale të shteteve anëtare, gjë e cila nuk « gëlltitet » lehtë në vendet e Ballkanit.

Ajo që është e përbashkët e të gjitha vendeve në Ballkan është dëshira dhe përpjekjet e tyre për në Bashkimin Evropian, por, kjo kulturë politike evropiane të cilës dëshirojnë të gjithë t'i bashkohen ka të bëjë me praktikën dhe 'detyrat' e parashtruara nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare, për ato shtete të cilat synojnë të hyjnë nën këtë çati.

Si mund t'i përkrahë Bashkimi Evropian tendencat e vendeve jo-anëtare t'i bashkohen kësaj kulture tjetër politike kur këto vende, për shembull Serbia dhe përkrahësit e saj, ende nuk janë të gatshëm të pranojnë sensin evropian të veprimtimit me dhe ndërmjet shteteve të ndryshme, veçanërisht me Kosovën.

Kultura politike po ashtu është e definuar si një model i orientimeve ndaj një numri të caqeve politike si: politikës së qeverisë, qeverisë së emëruar, politikanëve, institucioneve të qeverisë dhe vlerave të demokracisë. Dallimi ekziston në orientimet politike ndaj këtyre caqeve varësisht nga koha e fillimit të demokracisë në një shtet të caktuar. Mendimi se qytetarët në vende të sapo krijuara demokratike, respektivisht në vendet e dala nga sistemet socialiste dhe komuniste kanë më tepër tendencë të shfaqin pakënaqësinë e tyre me politikën qeveritare, pakënaqësinë me institucionet e demokracisë, nuk është e panjohur apo e huaj.

Kur merret parasysh edhe performanca ekonomike nuk ka shumë dallim ndërmjet demokracive të reja dhe të themeluara për sa i përket përkrahjes së institucioneve demokratike. Në këtë aspekt të zhvillimit ekonomik, mund të thuhet se në Evropë ka një kulturë të përbashkët politike. Megjithatë, një pjesë e kësaj të përbashkëte është e shprehur në qëndrimet negative ndaj institucioneve të ndonjë qeverie dhe ndonjë politikani në veçanti. Në aspektin ekonomik, shtetet e dala nga sistemet komuniste e socialiste, shtetet e reja e të sapokrijuara, shtetet në tranzicion, nuk mund të kapin shpejtë hapin e zhvillimit të saktë

dhe të drejtë ekonomik, të qeverisjes së drejtë dhe zhvillimit pa dallime të demokracisë, pa korrupsion e krim të organizuar të natyrave të ndryshme, zhvillim të cilin e kanë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, Evropës në tërësi dhe Amerikës. Prandaj edhe kultura politike në këtë fushë çalon dukshëm në vendet në tranzicion.

Çfarë është kultura politike ?

Pothuajse të gjitha shkrimet të cilat flasin për kulturën politike, ia dedikojnë domethënien e saj Alexis de Tocqueville-it dhënë në librin e tij « Democracy in America » (Demokracia Në Amerikë). Aty, Tocqueville kishte përshkruar 'despotizmin e butë' të cilin amerikanët e kishin mundur me sukses falë 'zakoneve të zemrës'. Por çfarë është despotizmi i butë sipas Tocquevill? Despotizmi i butë paraqet gjendjen në të cilën një vend mund të degradojë i teptitur nga një rrjet i rregullave të vogla e të komplikuar. Sipas tij despotizmi i butë dallon nga despotizmi i vërtetë në atë që despotizmi i butë nuk është i qartë për njerëzit. Ai ua jep përshtypjen e gabuar dhe të rreme njerëzve se ata e kontrollojnë situatën, por në fakt ata nuk kanë aspak ose kanë fare pak ndikim në qeverinë e tyre. Despotizmi i butë mbjell frikë, pasiguri dhe dyshime te e gjithë popullata në përgjithësi. Dhe Tocqueville vërejt se kjo dukuri është shmangur në Amerikë përmes 'zakoneve të zemrës' të popullatës së saj që në shekullin e 19-të.³(Tocqueville, Vëllimi II, Libri 4, Kapitulli 6 i «Demokracia në Amerikë »).

Prandaj mund të thuhet se kultura politike e një vendi paraqet një sërë qëndrimesh dhe praktikash të përkrahura nga një popull i cili edhe e formëso sjelljen respektivisht kulturën e tyre politike. Është një kornizë e përbashkët e një populli me vlera, besime dhe shprehje të sjelljes lidhur me, apo në raport me qeverinë dhe politikën. Këto ideale dhe struktura zhvillohen gradualisht dhe me kohë duke ndikuar në jetën politike të shtetit, rajonit dhe më gjerë, respektivisht i referohet qëndrimeve tona në aspektin e politikës, qeverisë dhe shoqërisë; në

³ Tocqueville, *Demokracia në Amerikë*, Vëllimi II, Libri 4, Kapitulli 6.

raportin ndërmjet qeverisë dhe popullatës, të drejtave dhe përgjegjësive të njerëzve, obligimeve të qeverisë dhe kufizimeve mbi autoritetin qeveritar. Në anën tjetër, qeveritë ndihmojnë në formësimin e kulturës politike dhe mendimit publik përmes arsimit, ngjarjeve dhe aktiviteteve publike, dhe kujtimit të së kaluarës.

Kultura politike dallon shumë nga shteti në shtet dhe shpeshherë dallon edhe brenda vetë një shteti. Në përgjithësi, sidoqoftë, kultura politike mbetet pak a shumë ajo që në të vërtetë është; mbetet e tillë për një kohë të gjatë, sepse është 'zakon i zemrës'.

Të themi se kultura politike dhe retorika serbe nuk kanë ndryshuar fare që nga viti 1912 në raport me shqiptarët e sidomos në raport me Kosovën, është e vërtetë. Nacionalizmi radikal serb i ringjallur në vitet e '80-ta, veçanërisht pas vdekjes së Josip Broz Titos, është ende aktiv. Nacionalizmi serb nuk shuhet dhe nuk vdes, ai e ndryshon 'gëzofin, pra mënyrën dhe mjetet, por jo edhe qëllimin. Ai shfaqet me strategji dhe taktika varësisht nga interesat e politikanëve serbë: lajkatar dhe i ndërgjegjshëm para përfaqësuesve të Bashkimit Evropian, ndërsa krejtësisht i kundërt në paraqitjen e qeveritarëve të saj para opinionit të vet serb. Për serbët, në kulturën e tyre politike, është më e rëndësishme të tregojnë nacionalizmin e bartur me shekuj në historinë, mitet, gjuhën dhe sjelljen sesa të përpiqen të besojnë në vlera universale njerëzore. Dhe e gjithë kjo, padyshim që ka ndikim në skenën politike, si në Ballkan ashtu edhe në tërë rajonin e Evropës, e të mos flasim për ndikimin që e ka një kulturë e tillë politike në raport me dhe ndaj shqiptarëve me të cilët është i rrethuar.

Tranzicioni në demokraci dhe rëndësia e kulturës politike

Presidenti i njohur Çek Vaclav Havel kishte thënë : « E kemi larguar sistemin totalitar por tani duhet ta fitojmë demokracinë »

Gjatë historisë ka periudha të zhvillimeve të qeta dhe në vazhdimësi, por po ashtu ka edhe periudha të ndryshimeve të ashpra dhe agresive kur forcat e pa aktivizuara të historisë shpërthejnë mbi sipërfaqe. Tranzicioni në demokraci dhe forcimi i demokracisë varet nga një numër faktorësh në një shtet. Përveç faktorëve që lidhen me zhvillimin ekonomik, social, edhe kultura politike e një vendi

konsiderohet si parakusht për zhvillimin e demokracisë. Fukuyama argumenton se « faktorët kulturorë veprojnë në nivelin më të thellë të shoqërisë duke ndikuar kësisoj nivelet ideologjike, institucionale dhe ato të shoqërisë civile». ⁴ Megjithatë është çështje më vete se hapat që duhet të ndërmerren për të ndjekur këtë zhvillim do të jenë të gjatë dhe shpesh edhe të dhimbshëm. Sundimi i ligjit, pjesëmarrja aktive e qytetarëve në zhvillimin e vendit dhe të demokracisë, bindja civile, të drejtat njerëzore dhe mbrojtja e kushtetutshmërisë konsiderohen si parakushte themelore në procesin e tranzicionit në demokraci.

Detyrë historike e shteteve të cilat kërkojnë zhvillim është ta zhvillojnë demokracinë si kulturë politike, por kjo do të thotë të krijohet diçka më shumë se legjislacion i thjeshtë apo krijim i organizatave dhe institucioneve. Kjo kërkon krijimin e kulturës politike. Themelimi i demokracisë në vendet në tranzicion nuk mund të sforcohet e të themelohet pa vullnet e dëshirë, apo të krijohet sipas një modeli të vetëm, përkundrazi, ai duhet të jetë i shumëllojshëm e i pangjashëm, i zgjedhur lirisht dhe të ndërtohet nga poshtë. Qasjet e ndryshme propagandohen në mbarë Evropën e zhvilluar, por për vendet në tranzicion ato do të jenë të suksesshme vetëm atëherë kur të gjithë do të mund ta vlerësojnë demokracinë si rrugë historike e zgjedhur lirisht. Shtetet e zhvilluara të Evropës po përpiqen të krijojnë një mekanizëm të efektshëm të rregullave dhe normave të parandalimit të konfliktit si dhe të menaxhimit të krizave mbështetur në konsensus të gjerë nacional dhe të drejtën për pjesëmarrje. Por, në vendet e Ballkanit Perëndimor një qasje e tillë nuk do ishte menjëherë frytdhënëse sepse transformimi i shoqërisë paraqet problem më të madh. Ekziston një konsensus i afërm në mes të qytetarëve dhe elitës politikë-bërës sa i përket, për shembull, fushës së ekonomisë, e ai është themelimi i sistemit të tregut por një treg i cili paraqet kombinimin e duhur të së drejtës njerëzore dhe sociale. Me qëllim të themelimit të një tregu të tillë social ekonomik, çelësi qëndron në procesin e privatizimit; asnjë shoqëri civile dhe ekonomike nuk mund të mbijetojë pa interes të pronës private. Sigurimi shëndetësor dhe

⁴ Francis Fukuyama.: *The Global Resurgence of Democracy: The primacy of Culture*. Baltimore : John Hopkins University Press, 1996

sigurimi pensional janë një domosdoshmëri tjetër. Inkorporimi i këtyre politikave dhe principeve evropiane nuk duhet të konsiderohen si ekskluzivitet i caktuar me patjetër, përkundrazi, sipas këtyre principeve parashihet që vendet në tranzicion të krijojnë shoqëri të qëndrueshme të rrënjësor në demokraci, por në përputhje me veçoritë ekonomike, politike dhe kulturore të shtetit dhe rajonit të cilit i takojnë. Sepse, të gjitha vendet e zhvilluara demokratike qoftë në Evropë, Amerikë e gjetkë, kanë vepruar kështu duke inkorporuar veçoritë e tyre kulturore, kombëtare, apo edhe fetare në qarqet institucionale, duke përdorur mënyrat dhe mjetet që janë dhe i përkasin shtetit amë.

Toleranca politike si element i kulturës politike

Të kesh dhe të mbash një qëndrim tolerant në shoqëri është një nga detyrat më të vështira me të cilën ballafaqohen qytetarët në një shoqëri. Ne nuk jemi të lindur as të ditur dhe as tolerantë, por mësojmë të bëhemi të tillë. Toleranca është koncepti kyç në teorinë bashkëkohore politike dhe në praktikë. Pa dyshim, është e lidhur me çështje shumë të vështira si: të drejtat, liria, neutraliteti shtetëror, kufijtë e tolerancës, etj. Megjithatë, sot, koncepti i tolerancës po ashtu prek disa çështje të rëndësishme politike: multikulturalizmin, pluralizmin, të drejtën e kulturës, interkulturalizmin dhe dialogun, si themele të demokracisë.

Toleranca politike është një çështje e studiuar mjaft në fusha të ndryshme si: sociologji, ekonomi, shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare, disiplina të ligjit e jurispondencës. Ajo duhet të kuptohet në rrethana dhe etapa të ndryshme.

Të zhvilluarit e tolerancës politike është e rëndësishme sepse forcon një shoqëri demokratike. Me një fjalë, toleranca politike nënkupton gatishmërinë e një shoqërie që t'i ofrojë, sigurojë e garantojë të drejtat themelore dhe liritë civile personave dhe grupeve të një vendi apo shteti, këndvështrimet e të cilëve dallojnë nga ato të të tjerëve. Dhe kjo paraqet një prej të drejtave themelore të njeriut.

Të drejtat dhe liritë individuale të cilat qytetarët e vendeve demokratike i respektojnë, nxisin një gamë të gjerë të ideve dhe

besimeve të ndryshme të cilat mund edhe të mos pranohen, të mos pëlqehen dhe shpesh edhe të kundërshtohen rreptë e të refuzohen nga anëtarët shumicë të një popullate. Në shoqëri demokratike këto vlera divergjente konsiderohen mjet mbrojtës kundër zhvillimit dhe përhapjes së tiranisë brenda një shoqërie. Megjithatë, shoqëria njerëzore, pavarësisht përpjekjeve për t'u çliruar nga 'prangat' e ndjenjës së nënçmimit dhe shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht të minoriteteve, e pranon një ndryshim të tillë me shumë vështirësi, ose thënë më mirë nuk e pranon pothuajse fare. T'i marrim shembull raportet ndërmjet popullit sllav dhe atij shqiptar: të dy palët deklarojnë një besim të fortë në parimet demokratike siç janë liria e fjalës dhe pjesëmarrja e duhur në kuvend apo parlament të vendeve në fjalë. Por nëse analizohet një çështje e tillë, në atë se praktikisht sa janë të gatshëm t'iu ofrojnë këto të drejta grupeve, idetë e të cilëve janë ndryshe nga idetë e tyre, me siguri përgjigjja nuk do të jetë ajo që pritet. Hendeku i jotolerancës mund edhe të zbehet me kalimin e kohës, por he për he, ai është i pandryshueshëm në këtë aspekt, sidomos në qëndrimet e serbëve ndaj jo-serbëve, në qëndrimet e pozitës ndaj opozitës, e kështu me radhë.

Ndikimi i nacionalizmit në kulturën politike: Serbia dhe Kosova

Nacionalizmi si term është mjaft i përhapur, edhe pse kuptimi i saktë i tij është gjithmonë i llojlojshëm, i ndryshëm dhe asnjëherë i njëjtë. Prandaj, nacionalizmi përkufizohet në disa definicione si: a) vetëdije politike e një përkatësie etnike dhe kohezioni etnik, identiteti politik dhe i interesave të përbashkëta kombëtare; b) ideologji politike i cili e konsideron kombin si përcaktuesin kryesor, më të rëndësishëm dhe fundamental të shoqërisë. Në këtë aspekt, nacionalizmi paraqet bazën e lëvizjeve politike për çlirimin kombëtar, barazi kombëtare dhe themelim dhe mbrojtjen e shtetit-komb ;c) preferencë në mbrojtjen e interesave të anëtarëve të një kombi kundruall interesave të anëtarëve të një kombi apo etnie tjetër ;d) mund të nënkuptojë edhe mbivlerësimin e veçorive dhe karakteristikave të njërit vend respektivisht kombi apo etnie duke i nënvlerësuar në anën tjetër

veçoritë dhe karakteristikat e një kombi apo etnie tjetër, me ç'rast lind jo toleranca mes anëtarëve të kombeve të ndryshme e në disa raste lindin edhe konfliktet etnike.⁵

Për shkak të të gjitha këtyre kuptimeve, nacionalizmi ka një vlerë të fortë, duke ngërthyer në vete karakterin politik dhe socio-psikologjik, si në nivel individual ashtu edhe në atë shoqëror. Prej këtu dhe del vlerësimi mbi nacionalizmin herë si pozitiv e herë negativ, si nga ana e aktorëve të ndryshëm politikë ashtu edhe nga ana e qytetarëve, në mjedise të ndryshme shoqërore dhe në ideologji dhe teori të ndryshme politike.

Nacionalizmi si një shprehje e aspiratave për shumë popuj në luftën e tyre për pavarësi kombëtare, liri dhe sovranitet është shfaqur që prej revolucioneve të shekujve 18 dhe 19, pastaj nëpër lëvizjet antikolonialiste e deri në kohën e rënies së komunizmit dhe daljeve nga federatat shumëkombëshe. Realizimi i një shteti-komb sovran ishte qëllimi kryesor i tyre pavarësisht periudhës historike dhe rrethanave apo konteksteve shoqëro-politike.⁶ Kjo shihet qartë në shembujt e shoqërive postkomuniste që kanë dalë nga shtetet shumëkombëshe si Bashkimi Sovjetik apo Jugosllavia, regjimi autoritar i të cilave ka kufizuar lirinë politike të njerëzve respektivisht të popullit, në përpjekje për t'i integruar ata në një komunitet të unifikuar politik i caktuar nga lart dhe mbi baza ideologjike. Është po ashtu e dukshme në shembujt e kombeve të vogla dhe/ose të minoriteteve etnike në vendet e zhvilluara demokratike perëndimore se konsensusi qytetar dhe sistemi demokratik politik nuk janë faktorë të njafueshëm të integritetit dhe rrjedhimisht as të stabilitetit të atyre komuniteteve politike, siç është rasti me Spanjën, Belgjikën, Britaninë e Madhe, Italianë apo Francën. Duhet gjithashtu të theksohet se pavarësisht nga proceset e globalizimit dhe prirjes për të krijuar një demokraci globale, e cila përveç tjerash ndjeshëm e zvogëlon sovranitetin e një shteti, ende ka mbetur çështje e hapur identiteti politik i cili është ende dominues në nivel të shteteve kombe. Kështu,

⁵ Ernest Gellner.: *Nacionalizmi*. Great Britain:Weidenfeld & Nicolson, 1997.

⁶ Berch Berberoglu.:*Nationalism and Ethnic Conflict: Class, State, and Nation in the Age of Globalization*.USA : Rowman &Littlefield Publishers, Inc., 2004.

nacionalizmi nuk paraqet një lloj lajthitjeje të demokracisë dhe as fenomen reaksionar apo jopërparimtar.

Në rastin Kosovë dhe Serbi, duhet t'i kthehemi për një çast tablosë së regjimit komunist në Jugosllavinë e Titos. Edhe pse barazia në mes të popujve dhe organizimi federal i shtetit jugosllav ishin një prej themeleve mbi të cilat qëndronte legjitimiteti i qeverisë komuniste, regjimi komunist autoritar ishte ai i cili gjeneroi nacionalizmin dhe atë, më së shumti përmes represionit dhe shtypjes së lirisë së shprehjes kombëtare sa herë që ajo konsiderohej se kalonte ca kufij. Këta kufij përcaktoheshin nga qeveria autoritare, kryesisht me anë të postulateve të ideologjisë komuniste të forcës në pushtet dhe përmes imponimit për ruajtjen e federatës shumëkombëshe si dhe përmes fuqisë së monopolit të partisë komuniste, që e mbante të drejtën ekskluzive për të interpretuar interesat kombëtare. Kushtetuta Jugosllave e vitit 1974, e cila duhej të garantonte një nivel të dukshëm të autonomisë dhe të shtetësisë formale për republikat dhe krahinat e saj, si dhe pavarësisht shpalljes së barazisë nacionale dhe solidaritetit si vlera themelore (i ashtuquajtimi 'bashkim-vëllazërim'), kufizoi dukshëm lirinë e deklaramit kombëtar dhe shprehjen e lirë politike. Regjimi komunist nuk mund t'i artikulonte ato të drejta të garantuara përmes kushtetutës në mënyrë efektive pa një demokratizim, i cili në anën tjetër do ta vinte në pikëpyetje monopolin e Partisë Komuniste dhe si pasojë e kësaj do ta vinte në pikëpyetje edhe mbijetesën e saj në pushtet. Pas vdekjes së Josip Broz Titos, nuk kishte më një autoritet të tillë i cili do të ishte arbitri midis udhëheqësve partiakë federalë dhe të udhëheqësve partiakë të republikave dhe i cili do të garantonte ruajtjen e unitetit të shtetit, kështu që proceset politike për decentralizimin e Jugosllavisë u rritën dhe u forcuan.⁷ Megjithatë, ato nuk u zhvilluan në mënyrë demokratike dhe Jugosllavia u shpërbë në mënyrë të dhunshme, me luftëra të përgjakshme dhe viktima e dëme të shumta në pothuajse të gjitha republikat e saj përfshirë këtu edhe Kosovën.

⁷ Dusan Bilandzic.: *Jugoslavia pas Titos :1980-1985*. Zagreb: Globus, 1986.

Por a ka ndryshuar kultura politike e Serbisë pas gjithë atyre ngjarjeve të nxitura prej tyre ? A është bërë ajo më demokratike, më tolerante dhe më arsyeshme ?

Përgjigja varet nga ajo se sa peshë i japim kësaj. Kultura politike në kuptimin e vet të gjerë të sentimenteve, e përcaktuar nga qëndrimet të cilat nuk janë asnjëherë homogjene dhe modelit simbolik, jo domosdoshmërisht koherent, të lidhur me përcaktimin dhe bërjen e politikës, duket sikur po ndryshon. Megjithatë, ajo nuk mund të qëndrojë më vete, pa mbështetjen e një strukture politike të shoqërisë që ndryshon. Kultura politike evoluon duhet të mbështetet në një sërë institucionesh të stabilizuara të cilat shërbejnë si kornizë për politikë-bërje në mënyrë tjetër nga ajo e shkuara, dhe në përputhje me rregullat e reja post-autoritare.

Si një bashkësi politike, qytetarët e Serbisë kanë marrë mësim nga përvoja e hidhur e viteve të '90-ta, dhe për një kohë deklarorin se po i vënë këto mësim (një kulturë emergjente politike) në praktikë. Këto ndryshime në qëndrimet dhe pikëpamjet politike mund të shërbenin për të parandaluar kthimin e mundshëm në të kaluarën. Askush nuk i dëshiron vitet e '90-ta të kthehen. Populli serb do të duhej të zhvillonte një lloj dyshimi të fortë apo dhe një lloj kundërshtimi ndaj thirrjeve demagogjike dhe populiste të politikanëve të tyre dhe për më tepër thirrjeve nacionaliste të Kishë Ortodokse Serbe. Sepse, ata do të duhej ta kishin kuptuar se sa i lartë ishte çmimi që ata e paguan. Por, njerëzit e zakonshëm serbë janë lënë vetëm që ta demokratizojnë petkun e tyre politik sa më mirë të mundën dhe dinë. Kjo vlen veçanërisht për qytetarët të cilët e inkurajonin demokracinë. Por, ajo që po ndodh në Serbi edhe tani tregon se kultura e tyre politike nuk ka ndryshuar pothuajse fare. Atraksioni i popullatës dhe përkrahja e madhe ndaj Partisë Radikale Serbe në njërin anë, dhe zgjedhja e një presidenti radikal siç është Tomislav Nikoliqi, në anën tjetër, tregon se kultura politike dhe retorika dominuese nacionaliste, etnocentrike dhe radikale nuk ka ndryshuar. Ky nacionalizëm i përdorur me mjeshtëri nga partia politike në pushtet bazohet në një identitet real nationalist serb, dhe pavarësisht qëllimeve dhe arsyeve për të cilat ky nacionalizëm shfrytëzohet, ai ekziston, ekziston shumë i fortë në

popullin serb, dhe si i tillë ndikon në skenën politike në tërë rajonin e Ballkanit por edhe në Evropë.

Ndërsa, kur flasim për kulturën politike në Kosovë, është e qartë se federata jugosllave, si një shtet me internacionalizmin dhe komunizmin si ideologji, kishte dështuar të ofronte në shkallë të njëjtë barazinë dhe liritë kombëtare. Edhe pse ky regjim ndërtohej dhe mbështetej mbi themele për tejkalimin apo thënë më mirë, për parandalimin e konflikteve etnike, nuk pati sukses për shkak të autoritarizmit dhe ideologjisë të ndërtuar në shoqëri. Në anën tjetër, ndrydhja e ndjenjave kombëtare nxiti frustrimin kolektiv. Përveç kësaj, autoritarizmi si karakteristikë dominuese socio-psikologjike ka kontribuar në ekzistimin e përhershëm të tensioneve ndëretnike gjatë regjimit komunist. Të gjithë këta faktorë kanë bërë që nacionalizmi shpërtheu me një forcë të tillë në këtë hapësirë, menjëherë pas rënies së regjimit. Për shkak të kufizimeve të lirisë politike, veçanërisht të lirisë së shprehjes së ndjenjave kombëtare dhe artikulimit të interesave kombëtare, ai regjim u perceptua si 'burgosje dhe prangosje' e popullit shqiptar. Prandaj, nacionalizmi u manifestua edhe si hakmarrje ndaj regjimit komunist. Këtyre shkaqeve politike mund t'iu shtohen edhe ato ekonomike. Pasiguria, rritja e problemeve ekonomike, mosmarrëveshjet politike dhe rritja e jostabilitetit politik ndikuan në krijimin e një gjendjeje të apatisë dhe pesimizmit, dhe në rritjen e frustrimit, hidhërimit dhe jotolerancës etnike. Padyshim që gjeneruesi më i madh i gjithë kësaj situatë ishte nacionalizmi serbomadhi i cili u bë edhe më i fortë gjatë krizës jugosllave. Dhe, po ky i njëjti nacionalizëm serbomadh ndikoi shumë në forcimin e nacionalizmit edhe te etnitë e tjera jo serbe që jetonin në Jugosllavi. Por, nacionalizmi luajti rolin kyç në shkatërrimin e sistemit komunist dhe në procesin e krijimit dhe ndërtimit të shteteve të pavarura.

Çfarë është gjendja dhe kultura politike sot në Kosovë? Shoqëria kosovare po përpiqet të bëjë atë çfarë di dhe mund ta bëjë, që ta ruajë dhe zhvillojë këtë pjesë të popullit shqiptar. Qeveria po mbështetet në 'udhëheqjen dhe udhëzimet' e Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare të saj si dhe të SHBA-së, duke u përpjekur që ta paraqesin Kosovën me një imazh të një vendi 'evropian', imazh ky që duhet të pëlqehet nga ndërkombëtarët. Kjo paraqet një anë të kulturës politike

në Kosovë. Tjetra që duhet bërë është orvatjet për të përmirësuar jetën sociale dhe ekonomike të qytetarëve të saj, orvatjet për të fituar besimin e qytetarëve përmes angazhimeve dhe detyrave të përmbushura ndaj vendit dhe qytetarëve të saj të cilët i udhëheq dhe i përfaqëson. Kosova ka mundësi të përparojë. Me konsolidimin e sistemit të ri shoqëror dhe politik, me zbutjen e presioneve të jashtme, me qëllime serioze për zhvillim, Kosova ka mundësi të zhvillohet. Periudha e normalizimit të jetës shoqërore dhe politike dhe periudha e rimëkëmbjes pas luftës, si dhe proceset e demokratizimit gjatë periudhës së tranzicionit, kanë kontribuar dukshëm në rënien e etnocentrizimit dhe forcimin e karakteristikave liberale të nacionalizmit. Nacionalizmi tani ka formë tjetër dhe si i tillë duhet të kultivohet dhe mbrohet me dinjitet dhe kulturë të lartë.

Bibliografi

Berberoglu, Berch.: *Nationalism and Ethnic Conflict* : Class, State, and Nation in the Age of Globalization. USA: Rowman & Littlefield Publishers, Inc., 2004.

Bilandzic, Dusan: *Jugoslavia pas Titos:1980-1985*. Zagreb: Globus, 1986.

Fukuyama, Francis.: *The Global Resurgence of Democracy* : The primacy of Culture. Baltimore : John Hopkins University Press, 1996.

Gellner, Ernest.: *Nacionalizmi*. Great Britain : Weidenfeld & Nicolson, 1997.

Kullashi, Muhamedin.: *Përplasja e identiteteve*. Prishtinë : Dukagjini, 2003.